



KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR

PLANI I MASAVE PËR MBYLLJEN E VITIT AKADEMIK 2019-2020

1. Përfundimi i procesit mësimor dhe të provimeve, sipas “Udhëzimit mbi mësimdhënien në distancë”, datë 24.03.2020, të Kolegjit Universitar “Bedër”, përfshi mbrojtjen e diplomave nga studentët e programeve të ciklit të parë dhe të tezave të studentëve të programeve të ciklit të dytë.
2. Shtyhet me 2 javë kalendari akademik duke përfshirë të gjithë elementet përbërëse të tij.
3. Studentët që dëshirojnë të marrin pjesë në leksione/seminare përsëritëse në auditor, të paraqesin me email kërkesën e arsyetuar pranë departamenteve gjegjëse, brenda datës 22 maj 2020.
4. Studentët që dëshirojnë të marrin pjesë në provim në auditor, të paraqesin me email kërkesën pranë departamenteve gjegjëse, brenda datës 22 maj 2020.
5. Studentët që dëshirojnë pezullimin e studimeve të semestrit të pranverës 2019-2020, për t'i përsëritur ato më pas, veprim për të cilin nuk do të ketë tarifë financiare shtesë, të paraqesin me email kërkesën pranë zyrës së sekretarisë mësimore dhe departamenteve, brenda datës 22 maj 2020.
6. Gjatë periudhës 1 deri 21 qershor, të gjithë pedagogët organizojnë leksione/seminare përsëritëse online.
7. Mbrojtja e tezës do të realizohet në platformat online për studentët e vitit të dytë “Master i shkencave”, në periudhën kohore 29.06.2020. - 07.07.2020.
8. Gjatë periudhës nga 1 deri 21 qershor, të gjithë studentëve që janë shprehur për vështirësi gjatë zhvillimit të procesit mësimor online, departamentet u planifikojnë leksione përsëritëse (të paktën 3 javë) në auditor, në grupe të vogla varësisht sipërfaqes së sallës duke respektuar distancën 1.5-2 metër.
9. Brenda datës 29 maj 2020, departamentet përgatisin dhe dorëzojnë pranë Fakulteteve planet për realizimin e procesit mësimor dhe përmbylljen e plotë online të vitit akademik 2019-2020.
10. Brenda datës 25 maj 2020, departamentet përgatisin listat e studentëve, sipas lëndëve, të cilët e kanë të pamundur ta përmbyllin lëndën online, bashkë me plan-propozimin për zhvillimin në auditor të leksioneve/seminareve online, përgjatë periudhës 1-21 qershor 2020 dhe i dorëzojnë ato pranë Fakulteteve.
11. Brenda datës 12 qershor 2020, për studentët që kanë paraqitur kërkesë me email, departamentet përgatisin plan-propozimin e organizimit të provimeve finale në auditor, në grupe të vogla varësisht sipërfaqes së sallës duke respektuar distancën 1.5 -2 metër.
12. Mbrojtja e tezës për programet e ciklit të dytë dhe punimi i diplomës për programet e ciklit të parë, përveç rasteve të veçanta, do të realizohet online, ndërkohë që procesi do të regjistrohet e arkivohet.